



FAKULTETI I EDUKIMIT DHE FILOLOGJISË, UNIVERSITETI “FAN S. NOLI” KORÇË
NË BASHKËPUNIM ME
FAKULTETIN FILOZOFIK TË UNIVERSITETIT TË PRISHTINËS DHE SHOQATËN
“PSIKOLOGËT SHQIPTARË”

ORGANIZOJNË

KONFERENCËN V SHKENCORE ME TEMË:

**ARRITJET DHE SFIDAT NË SHËRBIMET
PSIKO-SOCIALE**



KORÇË, 15-16 QERSHOR 2018

THIRRJA DHE NJOFTIMI I PARË PËR PJESËMARRJE NË KONFERENCË

Në vijim të zhvillimeve shoqërore dhe në referencë të sfidave të procesit integritit në tregun e punës, këndvështrimeve të reja mbi profesionin dhe praktikat aktuale të punës në terren, lind si nevojë e menjëhershme nxitja e debateve mbi vlerësimin e programeve të edukimit, evidentimin e problematikave, por edhe vlerësimin e modeleve më të mira të punës, fushat e ushtrimit të profesionit, modelet e bashkëpunimit, si dhe ndarjen e përvojave dhe vështrimeve kritike me profesionistë vendas dhe të huaj.

Pjesëmarrja aktive e përfaqësuesve të universiteteve në Shqipëri dhe më gjerë, të cilët përgatisin psikologë, edukatorë, punonjës socialë, mësues, specialistë, studiues, ofrues shërbimesh në sistemin penitenciar, përbën një mundësi shumë të mirë për diskutimin mbi sfidat dhe arritjet në programet akademike e profesionale të edukimit e të përgatitjes së profesionistëve në vend.

Duke e parë këtë konferencë si një takim të profesionistëve dhe të akademikëve të shkencave sociale, analiza e metodologjisë së shërbimeve dhe praktikave të tyre do të mundësojë përmirësimin e kurrikulave dhe programeve të formimit të profesionistëve.

Kjo veprimtari do të synojë të përmirësojë cilësinë e shërbimeve, njohuritë dhe shprehjet bazë që duhet të kenë profesionistët e rinj, si dhe do të garantojë që shërbimet psiko-sociale në institucionet dhe organizatat ku ofruesit e shërbimeve punojnë, të jenë sa më bashkëkohore. Gjithashtu një vend të posaçëm të vëmendjes formale do të zënë edhe diskutimet mbi kurrikulat rajonale e ndërkombëtare me të ftuar të universiteteve të huaja dhe rajonit, me përvojë disavjeçare në këtë fushë.

Konferenca do të mbahet në datat **15-16 Qershor 2018**, në mjediset e **Fakultetit të Edukimit dhe Filologjisë**, duke synuar krijimin e një rrjeti, ku profesionistë, studiues e akademikë të shkëmbejnë përvojat e tyre në praktikat e suksesshme të ofrimit të shërbimeve psiko-sociale.

TEMATIKAT KRYESORE TË KONFERENCËS JANË:

Modelet e praktikave më të mira të ofruesve të shërbimeve psiko-sociale si;

- Shërbimet psiko-sociale në arsim,
- Shërbimet psiko-sociale në shëndetësi,
- Shërbimet psiko-sociale në drejtësi penale
- Shërbimet rezidenciale
- Shërbimet e integruara në qendra komunitare.

Gjithashtu, do të merren parasysh edhe tema të tjera specifike, të cilat furnizojnë praktikat pozitive dhe cilësore në terren.

Konferenca është e hapur për akademikët e fushës së edukimit, drejtësisë penale, shëndetësisë, profesionistët, të diplomuarit alumni, studentë ekselence të të gjithë programeve të studimit universitar dhe ekspertë të tjerë të edukimit (mësues, mësues ndihmës, këshillues karriere, laborantë, psikologë, punonjës socialë, etj.), politikëbërës në fushat e arsimit dhe të edukimit në përgjithësi, aktorë aktivë të shoqërisë civile, përfaqësues të OJF-ve që operojnë në fushën e edukimit dhe në atë psiko-sociale, përfaqësues të Njërive Arsimore dhe të Shërbimeve Sociale.

Konferenca synon të kontribuojë në zhvillimin e një debati akademik, edukativ dhe shkencor për ndërtimin e urave të bashkëpunimit midis stafeve akademike që edukojnë (diplomojnë) profesionistë, evidentimin e sfidave të edukimit dhe debatin për kapërcimin e tyre në aspektin profesional të edukimit të profesionistëve, normëzimin dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Të gjithë të interesuarit nxiten të ndihmojnë në formësimin e kësaj konference me anë të punimeve të tyre kërkimore shkencore në formatin abstrakt, poster dhe artikull.

OBJEKTIVAT E KONFERENCËS

- Të nxisë një debat shkencor ndërmjet ekspertëve të fushës edukative dhe akademike, profesionistëve, praktikuesve dhe kërkuesve shkencorë nga vendi, rajoni dhe bota, që punojnë në edukimin dhe përgatitjen e profesionistëve në shkencë sociale dhe politikëbërësve, me qëllim promovimin e modeleve të praktikave profesionale si dhe angazhimin për bashkëpunim në këndvështrimin multidisiplinar.
- Të nxisë shkëmbimin e praktikave dhe modeleve të suksesshme në nivel kombëtar dhe ndërkombëtar, duke e krahasuar me përvojat më të mira europiane, midis akademikëve dhe profesionistëve, lidhur me përvojën e deritanishme në edukimin dhe kurrikulat e përgatitjes së punonjësve socialë.
- Evidentimi i fushave të suksesshme të aplikimit të këtij profesioni .

BOTIMI I AKTEVE TË KONFERENCËS

Të gjithë punimet e pranuar në konferencë do të botohen në Librin e Konferencës me ISBN. Pjesëmarrësit e konferencës do të marrin certifikatën e pjesëmarrjes, së bashku me kreditet e përfutuara nga pjesëmarrja në konferencë. Vetëm një pjesë e punimeve, të cilat do të kalojnë suksesshëm rishikimin shkencor, do të merren në konsideratë për t'u botuar në revista shkencore me faktor impakti.

Punimet të cilat nuk plotësojnë kushtet dhe kërkesat kryesore mbi abstraktin nuk do të pranohen.

BORDI SHKENCOR I KONFERENCËS:

Prof.dr. Ali Jashari , Universiteti“Fan S. Noli” Korçë
Prof. as. dr. Irena Nikaj, Universiteti“Fan S. Noli” Korçë
Prof.as.dr. Bujar Dugolli, Universiteti i Prishtinës
Prof.as.dr.Dashamir Berxulli, Universiteti i Prishtinës
Prof. dr. Edmond Dragoti, Universiteti i Tiranës
Prof. dr. Edmond Hajrizi, UBT, Prishtinë
Prof. as. dr. Artur Rada, Universiteti i Tiranës
Prof. as. dr. Gentiana Skura, Universiteti i Tiranës
Prof. as. dr. Fiona Todhri, Universiteti i Tiranës
Prof.as. dr. Nevila Koçollari Furxhi, Universiteti i Tiranës
Prof. as. dr. Elvira Dode, Universiteti i Elbasanit
Prof.as. dr. Blerina Xhakolli, Universiteti i Durrësit
Dr. Darina Çoni, Universiteti i Elbasanit
Dr. Sabina Belshaku, Universiteti i Elbasanit
Dr. Eris Dhamo, Universiteti i Tiranës
Dr. Eneida Frashëri, Universiteti “Marin Barleti” Tiranë

Data të rëndësishme:

Afati për pranimin e abstrakteve	25 Prill, 2018
Njoftimi për pranimin e abstraktit	15 Maj , 2018
Afati për dorëzimin e punimit	1 Qershor, 2018
Data e konferencës	16 Qershor, 2018
Vendi i mbajtjes së konferencës	Fakulteti i Edukimit dhe Filologjisë, Universiteti i Korçës
Gjuha zyrtare e konferencës	Shqip/Anglisht
Adresa zyrtare	konferencaedukimit2017fshe@ gmail.com

Informacione të rëndësishme

Tarifa e pjesëmarrjes për pedagogët dhe studiuesit kushton 5000 lekë për 1 autor.

Për çdo bashkautor shtohet pagesa me 2000 lekë, pra 2 autorë 7000 lekë, 3 autorë 9000 lekë (pagesa përfshin Certifikatën e pjesëmarrjes, Librin Proceedings të Konferencës me ISBN, drekën dhe kostot e tjera administrative);

Tarifa e pjesëmarrjes për mësuesit: 3000 lekë (pagesa përfshin prezantimin e punimit, kafën, katering, certifikatën e pjesëmarrjes me 3 kredite, kostot administrative)

Tarifa e pjesëmarrjes për studentët: 2000 Lekë (pagesa përfshin prezantimin e punimit, kafën, katering, certifikatën e pjesëmarrjes me 3 kredite, kostot administrative)

Detaje teknike

- Shkrimi në formatin A4, lloji i gërmës:12 pt. Font Times New Roman.
- Punimi duhet të jetë origjinal dhe i papublikuar më parë.
- Punimi duhet të dorëzohet në rrugë elektronike në adresën e mëposhtme:
- e-mail: [konferencaedukimit2017fshe@ gmail.com](mailto:konferencaedukimit2017fshe@gmail.com)
- Konfirmimi për pranimin e abstraktit do të dërgohet në rrugë elektronike në adresën personale të aplikantit.

UDHËZIME PËR ABSTRAKTIN

Abstrakti duhet të përshkruajë shkurtimisht çështjen studimore që do të diskutohet në artikull dhe të japë një përmbledhje koncize të gjetjeve.

Kërkesat kryesore mbi abstraktin:

- **Titulli:** Titulli i abstraktit duhet të jetë 12, Times New Roman, bold.
- **Emri i autorit:** Emri i plotë i autorit (autorëve), statusi, institucioni dhe adresa e-mail për secilin prej autorëve.

- **Përmbajtja:** Abstrakti duhet të jetë me gërma 12 pt., jo bold, hapësirë single, Times New Roman, si dhe duhet të jetë 250- 300 fjalë i gjatë.
- **Fjalët kyç:** Fjalët kyç duhet të jenë Times New Roman, me gërma 12 pt., jo më shumë se 5 fjalë, *italic*.
- **Formati:** Abstrakti duhet të dorëzohet në format Microsoft Word (doc ose docx).

Udhëzime për artikullin

Pjesëmarrësit e konferencës duhet të ndjekin stilin APA në shkrimin e artikullit. Udhëzimet APA japin sqarim të vlefshëm në të gjitha aspektet e procesit të shkrimit, që nga etika e autorësisë deri në zgjedhjen e fjalëve që ul më mirë paragjykimet në përdorimin e gjuhës.

Udhëzimet e përgjithshme APA:

- **Anët:** 1' në të gjitha anët
- **Madhësia dhe lloji i germës:** 12pt., Times New Roman
- **Hapësira mes rreshtave:** hapësirë dyshe në të gjithë artikullin, duke përfshirë titullin, abstraktin, trupin e dokumentit, referencat, shtojcat, shënimet në fund të faqes, tabelat dhe figurat.
- **Hapësira pas pikëzimit:** një hapësirë pas presjes, kolonës dhe gjysmë-kolonës brenda fjalisë. Dy hapësira pas shenjës së pikëzimit që mbaron fjalinë.
- **Renditja:** E renditur majtas (duke krijuar anë jo të njëjtë djathtas)
- **Dhëmbëzimi i paragrafit:** 5 hapësira
- **Vendosja e numrit të faqeve:** numri i faqeve është lart në qoshen e djathtë të çdo faqeje.
- **Renditja e faqeve:** faqja e titullit, abstrakti, trupi i artikullit, referencat, shënimet në fund të faqes, figurat, shtojcat.

INFORMACION SHITESË

Për të dërguar abstraktin dhe punimin, për të komunikuar njoftimet për pjesmarrjen dhe pagesat, si dhe për çdo informacion të nevojshëm, luteni të shkruani në adresën elektronike të konferencës: konferencaedukimit2017fshe@gmail.com Tel: 355 /692 456 473

BORDI ORGANIZATOR I KONFERENCËS
